

ANEKS 2

Kriteret e Shpërndarjes së Fondit të Kompensimit

Nivelet e Pushtetit Vendor	Kriteret
A. Fonde vetëm për bashkitë	<ul style="list-style-type: none">• Kompensimi për ripërshtatjen e kapacitetit fiskal, të biznesit të vogël të pa kompensuar, apo tregues të tjerë jo të saktë në përlogaritjet e formulës.• Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive.• Për konviktet e transferuar në nivel vendor.
B. Fonde vetëm për qarqet	<ul style="list-style-type: none">• Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Shuma që akordohet nga fondi i kompensimit për njësitë e qeverisjes vendore nuk duhet të kalojë 70 për qind të nivelit të transfertes së pakushtëzuar të akorduar me ligjin e buxhetit të vitit 2015.

Pjesa e papërdorur e fondit të kompensimit në vitin buxhetor 2015, kalon në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2016.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin Nr. 2, datë 6.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe në udhëzimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2014.

ANEKS 4

Për konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e pakushtëzuar të disa njësive të qeverisjes vendore përfshihen edhe fondet për mbulimin e kostos së plote të konvikteve të arsimit parauniversitar, ku përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative, shpenzimet për mirëmbajtjen dhe investimet.

Njësitet e qeverisjes vendore, që në transfertën e pakushtëzuar kanë të përfshirë koston e konvikteve të arsimit parauniversitar janë si më poshtë:

Bashkitë: Berat, Skrapar, Dibër, Mat, Durrës, Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Fier, Lushnjë, Elbasan, Cërrik, Gramsh, Korçë, Kolonjë, Lezhë, Mirditë, Kukës, Has, Shkodër, Malësi e Madhe, Vau-Dejës, Pukë, Tiranë, Kavajë, Vlorë dhe Sarandë.

Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas aneksit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, "Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1710, datë 29.12.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 502, datë 16.04.2008", për punonjësit edukative (zëvendës drejtor dhe edukator).

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitet e qeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit para fillimit të vitit fiskal 2015, duhet të dërgojë në njësitet e qeverisjes vendore gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me pagat dhe sigurimet shoqërore për konviktet e arsimit parauniversitar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitet e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.